

**Njoftim për përqendrim me të cilin Aramko Ovrzis Kompani B.V. Holandë, do të fitoj kontroll mbi  
Lotos SPV 1 sp.z.o.o. Poloni**

**(lënda nr. 08-42/2022)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë "nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më datë 11.02.2022, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës i është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin "Aramko Ovrzis Kompani B.V." (Aramco Overseas Company B.V.), me seli të regjistruar në Sheveningsever 62-66, 2517 KH Hag, Holandë, ka për qëllim të fitoj kontroll të pavarur mbi shoqërinë "Lotos SPV 1 sp. Z.o.o.", shoqëri me përgjegjësi të kufizuar nga Polonia, me seli të regjistruar në rr. Elblaska 135, 80-718 Gdansk, Poloni.

**Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktiviteti i tyre i biznesit :**

**Aramko Ovrzis Kompani B.V** është një shoqëri e varur në pronësi të plotë të Saudi Aramko.

**Aramko Ovrzis Kompani B.V** është një shoqëri me aktivitete të biznesit kryesisht në Evropë, Azi dhe Afrikë, duke u ofruar filialeve të saj në Saudi Aramco Global Group një gamë të gjerë shërbimesh, duke përfshirë shërbime të mbështetjes financiare, menaxhimi i zinxhirit të furnizimit të shërbimeve të mbështetjes teknike dhe një shumëllojshmëri shërbimesh mbështetëse administrative. Saudi Aramco është i angazhuar kryesisht në kërkime të mundshme gjeologjike, kërkim shpimin dhe nxjerrjen e substancave të hidrokarbureve dhe përpunimin, prodhimin, rafinimin dhe vendosjen në treg të këtyre substancave.

Saudi Aramko nuk ka shoqëri të varura në Maqedoninë e Veriut.

Saudi Aramko nuk ka aktivitete potencialisht relevante në lidhje me furnizimin me shumicë të karburanteve në Maqedoninë e Veriut.

**Lotos SPV 1 sp. Z.o.o.** është një shoqëri e varur në pronësi të plotë të shoqërisë tregtare të Grupit Lotos S.A. (Lotos Grupa S.A.), me seli të regjistruar në rr. Elblaska 135, 80-718 Gdansk, Poloni („Lotos"). Lotos SPV 1 sp.z.o.o. do të përfshijë të gjitha mjetet dhe punonjësit të cilët marrin pjesë në operacionet aktuale ose janë të nevojshëm për të siguruar qëndrueshmërinë dhe konkurrencën e fushës së biznesit për shitjen me shumicë të karburantit të Lotos Paliva sp. z.o.o. ( Lotos Paliwa sp.z.o.o), shoqëri e varur, në pronësi të plotë të Grupit Lotos S.A.

Sipas parashtruesit të njoftimit tregu relevant të cilit i referohet përqendrimi është tregu i furnizimit me karburante me shumicë.

*Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.*

*Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.*

15.02.2022

Shkup

